

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shëndeti - Mbi gjysma e personave me tension të lartë nuk e dinë se e kanë
ADRESA	https://www.syri.net/shendet/919649/mbi-gjysma-e-personave-me-tension-te-larte-nuk-e-dine-se-e-kane/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 09:40:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:00:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c6635cf25f5203627df18d09fd6927993e4eb874e266fca334d5d1806e388c39
TEKSTI	af8dc2e0659f075a3c0f29300314db22593db51dd2e2aa4c6fbc2c63a8579a31
PAMJA	ad7e378fb16f67c71f3321319d5bae9637d9c683d6d8dff68e6f580d86b6948a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	38578ab1c6c4ee80c929d3a924b9365041e6fb38c6507f622ed652eebc051f75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	abea285c66b625fda61d55a4ce47e92e047f4e5aa34cb0aedb7a5ee71b2cb2e0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/38578ab1c6c4ee80c929d3a924b9365041e6fb38c6507f622ed652eebc051f75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEĐA
'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU
Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



më të lexuarat

Si ndikoi spiritualizmi te zhvillimi i hershëm të kiropraktikës

A mund të ndikojë përdorimi i celularit gjatë shtatzënisë?

Fëmijët e njëqindvjeçarëve kanë rrezik më të ulët vdekjeje

Sindroma e lidhur me autizmin mund të prekë 1 në 7,300 njerëz, mijëra raste mbeten të padiagnostikuara

Suplementet shtesë që mund të kenë më shumë rëndësi se kurrë në të 40-at tua

A po e teprojmë me suplementet?


Nga javë në orë - teknologjia e re që përshpejton diagnostikimin e tumoreve të trurit



Mbi gjysma e personave me tension të lartë nuk e dinë se e kanë

11:00, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Më shumë se gjysma e personave që jetojnë me tension të lartë të gjakut nuk janë në dijeni për gjendjen e tyre, duke rritur kështu rrezikun për infarkt, goditje në tru dhe vdekje të parakohshme, sipas një studimi të ri.

Analiza e të dhënave nga Universiteti i Oksfordit tregon gjithashtu se vetëm rreth gjysma e pacientëve që trajtohen për hipertension arrijnë ta mbajnë tensionin nën kontroll.

Studiuesit analizuan të dhënat e rreth 1.4 milionë personave të regjistruar në programin "Our Future Health" dhe vlerësuan se më shumë se një e treta e të rriturve në Angli kanë tension të lartë. Nga këta, rreth 59 për qind nuk e dinin se vuanin nga kjo gjendje.

"Our Future Health" është programi më i madh kërkimor shëndetësor në Mbretërinë e Bashkuar dhe synon të ndihmojë në zhvillimin e mënyrave të reja për parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e sëmundjeve.

Studimi, i publikuar në revistën "BMJ Public Health", përfshiu persona të regjistruar mes viteve 2022 dhe 2025.

Tensioni i lartë u përkufizua si vlerë 140/90 mmHg ose më shumë, ose si përdorim i barnave për uljen e tensionit.

Hipertensioni më i zakonshëm te burrat

Rezultatet treguan se tensioni i lartë i gjakut ishte pothuajse 50 për qind më i zakonshëm te burrat sesa te gratë.

Në të gjitha grupmoshat, rreth 42 për qind e burrave kishin hipertension, krahasuar me 29 për qind të grave.

Gjendja ishte gjithashtu më e zakonshme te personat më të moshuar.

Autorët e studimit ngritën shqetësime se sistemi aktual i diagnostikimit dhe trajtimit mund të bëjë që një numër i madh personash të mbeten pa u identifikuar dhe pa marrë trajtimin e nevojshëm.

I lidhëzimet aktuale në Britani rekomandojnë që tensioni të matet për një periudhë

...kohore ose edhe në shtëpi përpara se diagnoza të konfirmohet.

Gjithashtu këshillohen ndryshime në stilin e jetës, krahas trajtimit me barna kur ai është i nevojshëm.

Sipas studiuesve, procesi me disa hapa mund të krijojë boshllëqe në kujdes, duke bërë që shumë raste të hipertensionit të mbeten të padiagnostikuara ose të trajtohen jo mjaftueshëm.

Ata theksuan gjithashtu se ngarkesa e madhe e mjekëve të kujdesit parësor me trajtimin e sëmundjeve ekzistuese lë më pak hapësirë për parandalim.

Shqetësim edhe për të rinjtë

Studiuesit vunë në dukje se edhe kur tensioni i lartë zbulohet gjatë kontrolleve shëndetësore, disa pacientë nuk marrin menjëherë trajtim me barna.

Një tjetër gjetje shqetësuese ishte se rreth 15.3 për qind e personave nën moshën 40 vjeç kishin hipertension.

Kjo është veçanërisht problematike, sipas autorëve, sepse të rinjtë zakonisht nuk përfshihen në programet standarde të kontrollit shëndetësor të NHS-së.

Edhe pse gjatë viteve 2000 u shënuan përmirësime të ndjeshme në zbulimin dhe kontrollin e tensionit të lartë, studiuesit thonë se progresi pothuajse është ndalur që nga viti 2011.

Ata vunë në dukje se pas pandemisë së Covid-19 janë parë edhe shenja përkeqësimi, ndoshta si pasojë e ndërprerjeve afatgjata në ofrimin e kujdesit shëndetësor.

Sipas studimit, niveli aktual i hipertensionit në Angli është i ngjashëm me atë të regjistruar rreth dy dekada më parë.

"Vrasësi i heshtur"

Wenyu Liu, statisticien mjekësor në Oxford Population Health dhe autori kryesor i studimit, tha se hipertensioni njihet si një "vrasës i heshtur", sepse shpesh nuk jep simptoma të dukshme.

Sipas tij, mënyra aktuale e zbulimit dhe trajtimit të tensionit të lartë nuk është mjaft efektive.

Iain Turnbull, zëvendësudrejtor mjekësor në "Our Future Health" dhe mjek i përgjithshëm, tha se shumë pacientë mbeten të pazbuluar ose nuk trajtohen në mënyrë optimale.

Ai theksoi nevojën për një qasje më aktive ndaj kontrollit të tensionit dhe për marrjen parasysh të rrezikut të përgjithshëm për sëmundje kardiovaskulare, jo vetëm të vlerave të tensionit.

Profesor Bryan Williams nga British Heart Foundation e cilësoi situatën shqetësuese.

Ai tha se tensioni i lartë mbetet faktori kryesor i modifikueshëm i rrezikut për sëmundjet kardiovaskulare dhe lidhet me rreth gjysmën e infarkteve dhe goditjeve në tru në Mbretërinë e Bashkuar.

Sipas tij, miliona njerëz vazhdojnë të jetojnë me hipertension pa e ditur dhe humbin kështu mundësinë për diagnostikim dhe trajtim të hershëm.

Zbulimi dhe trajtimi më i mirë i tensionit të lartë mund të ndihmojë dhjetëra mijëra persona të shmangin infarkte dhe goditje në tru që mund të parandalohen.

Më shumë se 11 milionë persona në Mbretërinë e Bashkuar janë diagnostikuar tashmë me tension të lartë nga mjekët e tyre, sipas analizave të British Heart Foundation.

Një zëdhënës i institutit NICE theksoi se udhëzimet aktuale nuk rekomandojnë shtyrjen e trajtimit vetëm për të provuar ndryshime në stilin e jetës.

Në vend të kësaj, këshillat për ushqyerjen, aktivitetin fizik dhe stilin e jetës duhet të shoqërohen me barna kur ato janë të nevojshme.

© SYRI.net

Lexo edhe:




Fëmijët e njëqindvjeçarëve kanë rrezik më të ulët vdekjeje



Artriti reumatoid: Pse dhimbja vazhdon edhe kur inflamacioni vihet nën kontroll?

...studimi



Studimi: Obeziteti dhe mbipesha u kushtojnë ekonomive evropiane miliarda euro në vit



Studimi i madh zbulon ngjashmëri mes kancerit të macet dhe njerëzit: Mund të ndihmojë në trajtimet e reja



Studim i ri: Rreziku i mbidiagnostikimit nga mamografia mund të jetë shumë më i ulët se sa mendohej

TË NGJASHME



Shumë gra po e ngatërrojnë këtë infeksion seksual me dhimbjet e ciklit



Studimi i madh zbulon ngjashmëri mes kancerit të macet dhe njerëzit: Mund të ndihmojë në trajtimet e reja



Nga javë në orë - teknologjia e re që përshpejton diagnostikimin e tumoreve të trurit



A po e teprojmë me suplementet?



Suplementet shtesë që mund të kenë më shumë rëndësi se kurrë në të 40-at tuaja



A mund të ndikojë përdorimi i celularit gjatë shtatzënisë?



Gjumi REM mbron shëndetin në mënyra që kohëzgjatja e gjumit nuk i tregon

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.